



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, LICENCAVE DHE PROJEKTEVE

RELACION TEKNIK

MBI REALIZIMIN E PROJEKTIT TE ZBATIMIT

**Objekti : “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin
Fratari”, Damës, Mallakastër”**

Vendodhja: Fshati Damës, NJA Fratar, Mallakastër

Investitori : Bashkia Mallakastër

GUSHT 2023

RELACION TEKNIK PER REALIZIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI: “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratar”, Damës, Mallakastër”

A. Vendodhja:

Fshati Damës, Njësia Administrative Fratar – MALLAKASTËR

Objekti “Ndërhyrje e menjëhershme në pronën publike, shkolla “Hajredin Fratar”, Damës, Mallakastër”, ndodhet në qendër të fshatit Damës, me investitor Bashkinë Mallakastër.

B. Të përgjithshme.

Realizimi i këtij projekti konsiston në ndërtimin e çatisë së tij. Objekti mbi të cilin do të ndërtohet çatia shërben si shkollë e mesme. Ky objekt është me konstrukcion betoni e beton arme, me mure tulle, mbuluar me soletë. Objekti ka qënë i mbuluar me çati, e cila është e djegur dhe për pasojë soleta ka pësuar dëmtime serioze duke rrezikuar edhe jetën e nxënësve të kësaj shkolle. Soleta e këtij objekti, për shkak të djegies së çatisë ekzistuese bëhet shkak për praninë e lagështisë në ambientet e brendshme të tij duke rrezikuar kështu shëndetin e fëmijëve të cilët frekuentojnë këtë objekt.

Për këtë arsye lind nevoja e ndërtimit të çatisë në këtë objekt si për të frenuar degradimin dhe shembjen e saj, për të zgjidhur problemin e lagështisë, por edhe për normalizimin e temperaturës së godinës si në periudhë të lagësht dhe në atë të thatë si dhe për paraqitje më të mirë të objektit pasi ndërtimi i saj duket më bukur vizualisht si dhe përshtatët me tipologjinë e banesave përreth saj.

C. Qëllimi.

Qëllimi i hartimit të këtij projekti është ndërtimi i çatisë së shkollës “Hajredin Fratar”, Damës, e cila ndalon degradimin e soletës si ndhe eliminon problemin e lageshtisë së hyn në objekt nga tarraca e tij.

D. Proceset e punës.

Në ndërtimin e çatisë së kësaj shkolle përfshihen këto procese pune:

1. Ndërtimin e çatisë;
2. Ndërtimi i ullukve horizontal dhe vertikal.



FIG.1. POZICIONIMI I SHKOLLËS “HAJREDIN FRATARI”

E. Të dhëna mbi ndërtimin e objektit.

Arsyeja e hartimit të këtij projekti është ndërtim i çatisë për efekt të mbrojtjes së soletës aktuale nga dëmtimi, izolimi hidrik dhe termik i godinës së kësaj shkolle. Përveç këtyre ndërtimi i saj do të përmirësojë dukshëm edhe pamjen e godinës.

Konfigurimi volumor u krye në përputhje me volumin ekzistues të godinës dhe me karakterin e ndërtimit. Është parashikuar me skelet druri ,bazament të gozhduar mbi soleten ekzistuese,

fiksimit e kollonave (baballeket) të drurit 10x10 cm sipas pjerrësisë, vendosja e mahive dhe listelave dhe në fund vendosja e tjegullave.

Çatia është konceptuar e tillë për arsye të funksionit që ka.

Largimi i ujrave do bëhet me ulluk horizontal dhe vertikal plastik. Ngjyra e tjegulles do të jetë klasike.

Punoi: